VENDIM
Nr. 189, datë 12.9.2024

MBI DHËNIEN E GARANCISË SË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA PARKU FOTOVOLTAIK "BLUE 1", I SHOQËRISË "SPV BLUE 1" SHPK, PËR MUAJIN KORRIK 2024

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; nenit 7 të "Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, i ndryshuar; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, i ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.9.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1553/13 prot., datë 9.9.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'SPV Blue 1' sh.p.k. për dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik 'Blue 1', për muajin korrik 2024",

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1553/8 prot., datë 13.8.2024, shoqëria "SPV Blue 1" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për pajisjen me garanci të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik "Blue 1", për muajin korrik 2024.
- Shoqëria është pajisur për herë të parë me GO nëpërmjet vendimit të Bordit të ERE-s nr. 158, datë 31.7.2024.
- Referuar nenit 14.2 të "Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", të ndryshuar, pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për certifikatë garancie origjine do të depozitojë për qëllime të këtij aplikimi vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1553.12 prot., datë 30.8.2024, shoqëria "SPV Blue 1" sh.p.k. ka bërë me dije se nuk ka asnjë ndryshim të dokumentacionit respektiv nga ai i depozituar për lëshimin e GO-së për herë të parë për këtë central.
- Mbështetur në përcaktimet e nenit 22, pikës 6, të ligjit nr. 24/2023, me shkresën nr. 1553/10 prot., datë 22.8.2024, ERE i është drejtuar OST sh.a., me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga ky impiant muajin korrik 2024.
- OST sh.a. ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1553/11 prot., datë 30.8.2024, ku ka informuar se sasia faktike e energjisë elektrike së injektuar në rrjetin e transmetimit nga impianti fotovoltaik "Blue 1" sh.p.k. për periudhën 1–31 korrik 2024 është 15,709 MWh.
- Në mbështetje të sa më sipër, vlerësohet dhënia e garancisë së origjinës për energjinë e prodhuar për periudhën 1–31 korrik 2024 nga parku fotovoltaik "Blue 1" sh.p.k., sipas sasive të deklaruara nga OST sh.a.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 22, pikës 5, të ligjit nr. 24/2023, *garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik "Blue 1", i shoqërisë "SPV Blue 1" sh.p.k., për periudhën 1–31 korrik 2024, për sasinë 15,709 MWh.

2. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë "SPV Blue 1" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti